

75/1
12.01.21



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME

MINISTRI

Nr. 168/Prot

Tiranë më 12/01/2021

URDHËR

Nr. 23, datë, 12.01.2021

PËR

**“PËR PROCEDURAT E PLOTËSIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË FORMULARËVE
TË DEKLARIMIT PERODIK”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.177 datë 16/07/2020 “Për procedurat e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.

URDHËROJ:

1. Çdo punonjës i Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat që ka përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar dhe do t'i nënshtrohen vlerësimit periodik, duhet të plotësojnë formularët e deklarimit.
2. Plotësimi i formularëve përfshin periudhën nga momenti i daljes së vendimit kalimtar dhe për çdo vit vijues.
3. Gjatë plotësimit të formularëve të vlerësimit periodik punonjësit e strukturave duhet të kenë parasysh:
 - a. Respektimin e afateve për plotësimin e formulareve.
 - b. Plotësimin e formularit sipas rubrikave përkatëse.

c. Shoqërimi i formularit me dokumentacion justifikues.

4. Strukturat përkatëse të Burimeve Njerëzore pranë Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave në Ministrinë e Brendshme janë përgjegjëse për:

a. Vënien në dispozicion të formularëve të detyrueshëm punonjësve të strukturave brenda afatit.

b. Marrjen në dorëzim të formularëve të sipërpërmëndur dhe dokumentacionit justifikues.

5. Shtojcat e këtij urdhëri përdoren si formularë të detyrueshëm për t'u plotësuar për vlerësimin periodik të punonjësve dhe për të gjithë punonjësit që emërohen në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

6. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij udhëzimi.

7. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

MINISTRI
BLEDAR CUÇI

